



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:230080

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05635211

Kom.Dh.Shk.II.nr.1700/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A, me numër unik identifikues 81128800 dhe seli në Prishtinë, kundër debitorit KK Mitrovicë, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, me NRB: 90000900, rr. Bedri Gjinaj p.n., Mitrovicë, të cilin me autorizim e përfaqëson L.Z., avokat nga Prishtina, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2645/22 i datës 29.09.2023, me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A, me numër unik identifikues 81128800 dhe seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2645/22 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2645/22 i datës 29.09.2023, e ka pranuar si i bazuar prapësimi i debitorit, KK Mitrovicë, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.396/22, i lejuar më datë 02.12.2022, nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të aplikimit të gabuar të se drejtës procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit ose të priset aktvendimi KPPP.nr.2645/22 i datës 17.10.2023 ashtu që të mbetet në fuqi urdhrin përmbarimore P.nr.396/22 i datës 02.12.2022.

Ankesa e të autorizuarës së kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, ku debitori ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e kreditorit dhe të vërtetohet aktvendimi KPPP.nr.2645/22 i datës 29.09.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Telekom i Kosovës SH.A, mbi bazën e dokumentit - faturës nr. 191031092646 ka lejuar urdhrin për përmbarim P.nr.396/22, të datës 02.12.2022, me të cilin është urdhëruar debitori, “KK Mitrovicë”, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat më sipër, brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të Urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,629,88 € me kamatëvonesë prej 8% duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme, përkatësisht nga datat sipas faturave të cekura më lart e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, Zyra Përmbarimore të zbatojë përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbarimore nuk ka tipare të përmbarueshmërisë sepse e njëjta nuk është pranuar-nënshkruar dhe vulosur nga debitori. Gjykatës i ka kërkuar që konform neneve 27, 29 71 dhe 73 që ta aprovoj prapësimin si të bazuar, ta anuloj urdhrin përmbarimor si dhe të obligohet kreditori që t’ia paguaj debitorit të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar prapësimi i debitorit nuk i plotëson kushtet e parapara konform nenit 69 pika 4 të LPP-së, duke shtuar se pretendimet e debitorit se fatura nuk i ka pranuar nuk qëndrojnë sepse debitori ka pranuar në baza mujore email në emailin: ...@rks-gov.net i caktuar menaxher i kontratës z. SH.G. nga Komuna e Mitrovicës, me korrespondencën e datës 08.03.2022 vërtetohet se që të gjitha shërbimet janë shfrytëzuar nga debitorit deri me dt.31.12.2021. Tutje shton se ka kërkuar vazhdimisht që të realizohet kërkesa ku vërtetohet edhe me korrespondencën e datës 06.10.2022, 30.08.2022 dhe 12.08.2022. Gjykatës i ka propozuar të caktojë seancë publike për të kuptuar validitetin e prapësimit ose konform nenit 73 par.3 të LPP-së të aprovoj përgjigjen në prapësim si të bazuar dhe ta refuzon dhe hedhë poshtë si të pakompletuar, të pa lejuar dhe të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2645/22 i datës 29.09.2023,e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit, KK Mitrovicë, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.396/22, i lejuar më datë 02.12.2022, nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, e ka shfuqizuar, duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pasi analizoj prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të gjeti se i njëjti është i bazuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkëlqje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht nenin 29 paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla”. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Prandaj, në këtë rast vlerëson se fatura me numër 191031092646, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Prandaj, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit, duke e pranuar prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.396/22 të datës 02.12.2022, me arsyetimin se në rastin konkret Fatura: 191031092646, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka shfuqizuar edhe procedurën përmbartimore, me arsyetimin se duke u mbështetur në dispozitat në fuqi, rezulton se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në 3 faturë nuk janë përkrahur shërbimet e ofruara debitorit dhe në të njëjtën nuk është përcaktuar saktë shuma e cila është detyrim për periudhën kohore për të cilën është lëshuar fatura, 01.12.21-31.12.21, për arsye se në faturë është përcaktuar borxhi paraprak në lartësi prej EUR 369,66 euro, mirëpo nuk është treguar se si ka rrjedhur ky borxh i debitorit, për cilat shërbime apo për cilën periudhë kohore. Gjithashtu, nga faturat e bashkëngjitura në përgjigjen në prapësim të kreditorit, nuk përpunohen shumat e periudhës së kërkuar me urdhrin përmbartimor, ku totali i tyre tregon shumë më të lartë se ajo që e ka fatura me borxh total për periudhën 01.12.21-31.12.21.

Po ashtu, Kjo Gjykate vlerëson se fatura nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe e njëjta nuk rezulton të jetë pranuar nga debitori. Ndërsa, në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën dëshmohet se kjo faturë i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë të rregullt, dhe si e tillë, fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri paraqet dokument të njëanshëm.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i vlerësoi edhe pretendimet e kreditorit se debitori ka pranuar në baza mujore fatura në emailin ...@rks-gov.net, i caktuar menaxher i kontratës z. SH.G.nga Komuna e Mitrovicës, dhe se me korrespondencën e datës 08.03.2022 vërtetohet se që të gjitha shërbimet janë shfrytëzuar nga debitori deri me dt.31.12.2021, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuar në shkresat e lëndës, kjo për faktin se përkundër asaj se SH.G.,

Drejtor për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, me emailin e datës 25.11.2021 e ka njoftuar kreditorin për ndalimin e pakove pas muajit dhjetor 2021, nuk vërteton se i ka pranuar faturat me të cilat është iniciuar propozimi për përmbarim. Për më shumë, nga emaili i datës 30.08.2022 i dërguar përfaqësuesve të kreditorit nga Drejtori i Drejtorisë për Administratë të përgjithshme, rrjedh se faturat për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2021 Komuna e Mitrovicës nuk i ka pranuar dhe protokolluar andaj edhe kanë sqaruar se nuk mund të marrin obligim për pagesën e të njëjtave, e që rrjedhimisht borxhi i kërkuar është kundërshtuar nga debitori.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP “baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, me çka debitori ka ofruar provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit lidhur me propozimin për përmbarim të lëshuar nga përmbaruesi privat, për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton së fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarimi , për shkak se nuk i plotëson kushtet ligjore, për arsyes se fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështroon sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe kur e ka shfuqizuar urdhrin përmbarimore P.nr.396/22 të datës 02.12.2022 këtë çështje.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1700/23 dt.29.04.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova